



STATUTI

I AKADEMISË SË SHKENCAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të **KODIT EUROPIAN TË SJELLJES PËR INTEGRITET NË KËRKIMIN SHKENCOR**, Asambleja e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë miraton këtë
(Amenduar me Vendimin Nr. 15, datë 30 qershor 2017 të Asamblesë së ASH-së)

S t a t u t

I Dispozita të përgjithshme

Neni 1

1. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë (më tej Akademia) është institucioni më i lartë shkencor në Republikën e Shqipërisë.
2. Akademia është person juridik publik, me detyra, të drejta e përgjegjësi të përcaktuara në Kushtetutë, në ligjin për Akademinë dhe në akte të tjera normative të veçanta, të konkretizuara në këtë Statut.
3. Selia e Akademisë është në Tiranë.
4. Akademia ka emblemën e vet.
5. Akademia ka vulën e vet të rrumbullakët me tekstin në gjuhën shqipe.
6. Dita e themelimit të Akademisë është 10 tetor 1972.
7. Akademia e Shkencave vepron nëpërmjet një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh.
8. Akademia është institucion me autonomi organizative dhe pavarësi shkencore. Ajo në veprimtarinë e saj udhëhiqet nga e vërteta shkencore dhe interesat kombëtarë, duke siguruar shprehjen e lirë të mendimit shkencor.
9. Akademia synon të vendosë një raport të drejtë ndërmjet lirisë së kërkimit shkencor dhe domosdoshmërisë së përfitimit, në shërbim të zhvillimit të vendit, nga financimi i dhënë prej shtetit.
10. Akademia ka të drejtën e pronësisë mbi produktin e veprimtarisë së vet shkencore dhe mbi pasuri monetare e materiale të siguruara me rrugë ligjore.

II Funksionet e Akademisë së Shkencave

Neni 2

1. Akademia koordinon, mbështet dhe nxit kërkimin shkencor të anëtarëve të saj.
2. Nëpërmjet anëtarëve të saj dhe të grupeve të specialistëve udhëheq projekte, kryen kërkime e studime me karakter teorik dhe aplikativ në fusha të ndryshme të shkencave që mbulon, si dhe ndihmon për zbatimin e këtyre studimeve.
3. Propozon për të hapur fusha të reja kërkimesh e studimesh shkencore në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit
4. U ofron institucioneve të larta shtetërore këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme të zhvillimit të vendit, si edhe jep mendimin për hartimin e ligjeve që lidhen me shkencën.
5. Bashkëpunon me institucione e qendra të tjera shkencore publike e private brenda vendit, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës.
6. Vendos e zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shkencore të vendeve të tjera; ndihmon në bashkërendimin e veprimtarisë së organizmave të ndryshëm shkencorë, që mund të funksionojnë pranë saj, si dhe me organizata shkencore ndërkombëtare, për arritjen e një integrimi sa më të frytshëm të saj në shkencën botërore.
7. Boton organe periodike të specializuara dhe vepra të tjera shkencore në të gjitha fushat e shkencës.
8. Organizon kongrese e konferenca shkencore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.
9. Kujdeset për rregullimin e raportit të zhvillimit të disiplinave shkencore dhe të përfaqësimit të tyre në Akademi në përputhje me nevojat e vendit dhe me arritjet e shkencave në fusha të ndryshme.
10. Formon komisione e grupe pune të përhershme ose të përkohshme me rëndësi kombëtare në mbështetje të strategjive për kërkim e zhvillim, për organizimin e studimeve ndërdisiplinore me pjesëmarrjen e anëtarëve të saj dhe të studiuesve jashtë Akademisë.
11. Organizon konkurse e dhënie çmimesh shkencore, lektoriume e promovime veprash, jep ose njeh patenta në kërkimin shkencor, koncepton e realizon me të

drejtën e autorit emisione radio-televizive, mbledh dhe informatizon të dhënat e punës shkencore etj.

12. Kujdeset për të drejtat e anëtarëve të vet, të gjithë akademikëve si dhe të punonjësve të tjerë shkencorë, për krijimin e kushteve të përshtatshme jetësore e materiale për veprimtari shkencore.

III

Përbërja e Akademisë së Shkencave

Neni 3

1. Në strukturën e Akademisë hyjnë asambleja, seksionet, këshilli ekzekutiv, kryesia, biblioteka dhe sektorët administrativë.

2. Akademia ka në përbërje anëtarë të rregullt, anëtarë të përhershëm, anëtarë të asociuar dhe anëtarë nderi.

3. Anëtarët e rregullt dhe të përhershëm të Akademisë mbajnë titullin “Akademik”, të cilin e ruajnë edhe pas daljes në pension. Ata janë jo më shumë se 30 veta. Anëtarë të përhershëm janë deri në 10 veta. Titulli “Akademik” është titull shkencor.

4. Anëtarët e asociuar të Akademisë janë jo më shumë se 15 veta dhe mbajnë titullin “Akademik i asociuar”.

5. Asambleja përbëhet nga anëtarët e rregullt, anëtarët e përhershëm dhe anëtarët e asociuar. Si rregull çdo dy vjet ajo cakton numrin e anëtarëve të rinj të rregullt dhe të përhershëm që do të pranohen derisa të plotësohet numri prej 30 anëtarësh.

6. E njëjta procedurë ndiqet edhe për pranimin e anëtarëve të asociuar, derisa të plotësohet numri prej 15 vetash.

7. Anëtarët e rregullt të Akademisë pranohen nga radhët e anëtarëve të asociuar dhe, në raste të veçanta, nga shkencëtarë të tjerë që nuk kanë qenë më parë anëtarë të asociuar, por duhet të marrin të paktën tri të pestat e votave të anëtarëve të Asamblesë.

8. Anëtarët e nderit janë jo më shumë se 28 veta.

Neni 4

1. Anëtarët e rregullt të Akademisë zgjidhen nga radhët e shkencëtarëve të shquar me titull “Profesor”, që janë edhe anëtarë të asociuar të Akademisë, që kanë

ose kanë pasur shtetësi shqiptare, që nëpërmjet punimeve origjinale e veprave përgjithësuese me një nivel të lartë shkencor kanë zgjidhur teorikisht e praktikisht probleme të një rëndësie të veçantë në fushën e shkencës, të ekonomisë, të artit dhe të kulturës, si edhe kanë dhënë kontribute të veçanta në formimin universitar e pasuniversitar të shkencëtarëve të rinj. Anëtarë të rregullt të Akademisë zgjidhen edhe nga radhët e shkencëtarëve të shquar shqiptarë, që nuk e kanë fituar titullin “Profesor” në Shqipëri, por kanë gradën shkencore “PhD” ose “Doktor”, të cilët punojnë aktualisht pranë universiteteve ose pranë qendrave kërkimore jashtë vendit dhe kanë kontribute akademike, që tejkalojnë parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi për kërkimin e titullit “Profesor”. Pas plotësimit të numrit të caktuar, pranimi i anëtarëve të rinj bëhet vetëm për vendet e lira, por jo detyrimisht nga fushat ku janë krijuar vendet e lira.

2. Në raste të veçanta, anëtarë të rregullt të Akademisë mund të zgjidhen personalitete edhe pa titullin “Profesor”, që kanë merita të shquara në fusha të ndryshme të krijimtarisë letrare e artistike.

3. Anëtarë të përhershëm të Akademisë zgjidhen nga akademikët që kanë mbushur moshën 75 vjeç dhe kanë kontribute të shquara, të vlerësuara gjerësisht në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

4. Anëtarët e asociuar të Akademisë zgjidhen nga radhët e shkencëtarëve me titull “Profesor”, që kanë ose kanë pasur shtetësi shqiptare, të cilët nëpërmjet punimeve e veprave shkencore kanë dhënë kontribute të rëndësishme në zhvillimin e shkencës dhe në formimin universitar e pasuniversitar të shkencëtarëve të rinj. Anëtarë të asociuar të Akademisë zgjidhen edhe nga radhët e shkencëtarëve të shquar shqiptarë që nuk e kanë fituar titullin “Profesor” në Shqipëri, por kanë gradën shkencore “PhD” ose “Doktor” dhe punojnë aktualisht pranë universiteteve ose pranë qendrave kërkimore jashtë vendit, si edhe kanë kontribute akademike që tejkalojnë parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi për kërkimin e titullit “Profesor”. Pas plotësimit të numrit të caktuar pranimi i anëtarëve të rinj të asociuar bëhet vetëm për vendet e lira, por jo detyrimisht nga fushat ku janë krijuar vendet e lira.

5. Anëtarët e nderit zgjidhen nga radhët e personaliteteve të njohura të vendeve të tjera, të cilët kanë dhënë kontribute të shquara në kërkimin shkencor në dobi të zhvillimit të vendit tonë.

6. Funkionarët e lartë të administratës shtetërore dhe të partive politike nuk

mund të kandidojnë për t'u zgjedhur anëtarë të rregullt ose të asociuar të Akademisë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

7. Anëtarët e rregullt, anëtarët e asociuar dhe ata të përhershëm të Akademisë së Shkencave, përpara zgjedhjes në funksionet drejtuese të përkrahura në nenet 18 dhe 19 të këtij Statuti, duhet të plotësojnë pyetësorin *Formular aplikimi për informim për zyrtarët përpara emërimit / zgjedhjes në poste të larta*, parashikuar në nenin 29, pika 1, germa gj, të Ligjit nr. 45/2015 *Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*.

(Amenduar me Vendimin nr. 15, datë 30 qershor 2017 të Asamblesë së Akademisë së Shkencave)

Neni 5

Anëtarët e rregullt, të përhershëm dhe të asociuar të Akademisë:

Kanë detyrë:

1. Të marrin pjesë rregullisht e në mënyrë aktive në mbledhjet e Asamblesë së Akademisë dhe në mbledhjet e seksioneve përkatëse; për mungesa pa arsye të mjaftueshme më shumë se një vit, Asambleja, me propozim të Kryesisë së Akademisë, shqyrton qëndrimin ndaj tyre dhe u tërheq vëmendjen.

2. Të plotësojnë detyrimet që lindin nga statusi i tyre si anëtarë të Asamblesë së Akademisë.

3. Të kontribuojnë drejtpërdrejt me veprimtarinë vetjake ose me cilësinë e tyre si drejtues grupesh a projektesh shkencore, brenda dhe jashtë Akademisë, në studimin dhe zgjidhjen e problemeve të rëndësishme të shkencës.

4. Të referojnë periodikisht në organizmat e fushës përkatëse shkencore për arritjet në veprimtarinë e tyre.

5. T'i parashirojnë, sipas nevojës, seksionit ose Asamblesë së Akademisë probleme të rëndësishme shkencore.

6. Të raportojnë në fund të çdo viti për veprimtarinë e tyre akademike dhe të paraqesin listën e plotë të botimeve, të referimeve dhe të projekteve shkencore, e cila publikohet edhe në faqen e internetit të Akademisë.

7. Të dorëzojnë në arkivin (e zakonshëm dhe atë elektronik) e Akademisë një kopje për çdo punim shkencor të raportuar në raportin e veprimtarisë dhe në listën e botimeve shkencore.

Kanë të drejtë:

1. Të përfitojnë nga mundësitë financiare të Akademisë për botim veprash, për shërbime kërkimore shkencore brenda e jashtë vendit etj.; të shfrytëzojnë lirisht fondet bibliotekare e arkivore që ka Akademia, aparaturat elektronike të lira dhe çdo mundësi tjetër materiale, që u shërben atyre për punën kërkimore shkencore; të promovojnë botimet e tyre shkencore në mjediset e Akademisë.
2. Të udhëheqin projekte shkencore të Akademisë dhe të propozojnë grupin bashkëpunues në këto projekte; projekti, platforma dhe grupi realizues miratohen nga seksioni përkatës.
3. Të përdorin lirisht titullin shkencor “Akademik” në botimet e veta ose në forma të tjera të paraqitjes së tyre publike.
4. Të paraqitin për botim në Akademi punimet e tyre.
5. Të përdorin lirisht të drejtën e votës në të gjitha rastet që përcaktohen në këtë Statut.
6. Të zgjidhen në organet drejtuese të Akademisë.

Neni 6

Propozimet për anëtarë të rinj të Akademisë bëhen sipas kësaj procedure:

- a) Asambleja, me propozimin e Kryesisë së Akademisë, cakton fushat e shkencës në të cilat do të pranohen anëtarët e rinj dhe numrin përkatës.
- b) Të drejtën e propozimit të kandidatëve e kanë anëtarët e Akademisë, këshillat e profesorëve të fakulteteve a të instituteve shkencore, si dhe senatet e shkollave të larta. Personat e interesuar kanë të drejtë të aplikojnë edhe drejtpërdrejt, me kusht që të kenë edhe dy referenca nga shkencëtarë që kanë bashkëpunuar me ta.
- c) Seksionit përkatës të Akademisë i paraqiten dosjet e të gjithë kandidatëve të paraqitur.
- ç) Mbledhja plenare e Seksionit, me votim të fshehtë dhe me shumicën e thjeshtë të votave (jo më pak se 50%+1) të të gjithë anëtarëve të Seksionit, voton për kandidaturat e paraqitura. Rezultatet e votimit, që ka vlerë këshillimore, dhe dosjet e gjithë kandidatëve i përcillen Kryesisë së Akademisë, e cila ia parashton për shqyrtim e miratim Asamblesë.
- d) Nga Asambleja, në rast se për çdo fushë të shkencës ose vend të lirë janë paraqitur më shumë kandidatura sesa numri i caktuar, zgjidhen aq kandidatë sa është numri i parashikuar. Po qe se asnjëri nga kandidatët nuk fiton votat e shumicës së të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Akademisë (jo më pak se 50%+1),

votimi përsëritet veç e veç për kandidatët që kanë fituar jo më pak se 40 për qind të votave (aq kandidatë sa është numri i caktuar) dhe fitojnë përfundimisht kandidati ose kandidatët që kanë marrë shumicën e thjeshtë të votave (jo më pak se 50%+1) të anëtarëve të pranishëm të Asamblesë së Akademisë, pas një votimi të fshehtë.

dh) Kjo procedurë zbatohet edhe për pranimin e anëtarëve të asociuar. Këta mund të konkurrojnë për anëtarë të rregullt në çdo kohë që shpallen vende të lira.

Neni 7

Propozimet për pranim si anëtarë të Akademisë të personaliteteve, që kanë merita të shquara në fushën e krijimtarisë letrare dhe artistike, i paraqiten Asamblesë nga Kryesia e Akademisë, pasi për këto kandidatura të ketë dhënë mendim edhe seksioni përkatës.

Propozimet për pranimin e anëtarëve të nderit i bëhen Asamblesë nga Kryesia e Akademisë.

Neni 8

1. Akademikët, që kanë mbushur moshën 75 vjeç dhe që duan të kandidojnë për anëtarë të përhershëm, i paraqesin kërkesë Kryesisë së Akademisë.

2. Akademikët në pension mund të marrin pjesë në projekte, të përkrahen në kryerjen e studimeve dhe në botimin e tyre etj.

Neni 9

Pranimi i anëtarëve të rregullt, i anëtarëve të përhershëm, i anëtarëve të asociuar dhe i anëtarëve të nderit bëhet nga Asambleja me votim të fshehtë.

Në mbledhje duhet të jenë të pranishëm jo më pak se $\frac{3}{4}$ e anëtarëve të saj.

Për pranimin e anëtarëve të rinj të rregullt, të anëtarëve të përhershëm dhe të anëtarëve të rinj të asociuar kanë të drejtë vote të gjithë anëtarët e Asamblesë, sipas ligjit.

Neni 10

1. Statusi i anëtarit të rregullt, i atij të asociuar dhe i çdo funksioni tjetër drejtues të lidhur me këto funksione, përfundon kur anëtari:

a) mbush moshën 75-vjeç;

b) jep dorëheqjen;

c) zgjidhet ose emërohet në funksione drejtuese në parti politike a në organe kushtetuese;

ç) deklarohet i paaftë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) shkarkohet me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të Asamblesë për akte e sjellje që cenojnë rëndë figurën e anëtarit të Akademisë. Të tilla klasifikohen edhe të dhënat e manipuluar, plagjiatura, përvetësimi dhe botimi i të dhënave ose i materialeve bazë studimore pa lejen e autorit, si dhe të dhënat e pavërteta ose të manipuluar të përdorura për botimet shkencore;

e) ndërron jetë.

2. Statusi i anëtarit të përhershëm përfundon kur vërtetohet një nga rastet e mësipërme me përjashtim të atij të parashikuar në shkronjën “a”.

3. Statusi i anëtarit të nderit përfundon kur vërtetohet një nga rastet e mësipërme, me përjashtim të atyre të parashikuara në shkronjat “a” dhe “c”.

Neni 11

Procedurat për plotësimin e vendeve të lira, të krijuara për shkak të përfundimit të funksionit, sipas pikës 1 të nenit 10, fillojnë jo më vonë se dy muaj para përfundimit të funksionit sipas shkronjës “a” dhe jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të tij, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e” të pikës 1 të nenit 10.

Neni 12

1. Pranimi në Akademi si anëtar i rregullt, i përhershëm ose i asociuar nuk nënkupton një vend pune me kohë të plotë dhe të pagueshme në Akademi.

2. Anëtarët e Akademisë që kanë vende pune me kohë të plotë dhe të pagueshme në Akademi, janë anëtarët e Kryesisë dhe drejtuesit e seksioneve.

3. Anëtarët e rregullt të Akademisë me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, që janë në marrëdhënie pune, krahas pagës, sipas vendit të punës, përfitojnë edhe shpërblimin mujor për titullin ‘Akademik’ në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ata, krahas pensionit që u takon si profesor, marrin edhe shpërblimin mujor për titullin “Akademik”.

4. Nga buxheti i Akademisë paguhet shpërblimi për titullin “Akademik” dhe mbështetet veprimtaria shkencore e akademikëve.

IV Drejtimi i Akademisë së Shkencave

Neni 13

Organet drejtuese të Akademisë janë Asambleja, Këshilli Ekzekutiv dhe Kryesia e Akademisë.

Neni 14

Asambleja është organi më i lartë drejtues i Akademisë.

Asambleja mbledhet të paktën dy herë në vit. Ajo mbledhet edhe kur këtë e kërkojnë dhjetë (10) anëtarë të saj.

Në mbledhjen e Asamblesë, sipas rastit, përveç anëtarëve të caktuar me ligj, mund të marrin pjesë edhe të ftuar të tjerë, me përjashtim të rasteve kur në këtë statut është parashikuar ndryshe.

Në Asamble kanë të drejtë vote vendimore anëtarët e rregullt, të përhershëm dhe të asociuar të Akademisë, sipas ligjit.

Të drejtën e votës vendimore e kanë edhe anëtarët e Asamblesë mbi 75 vjeç, kur marrin pjesë në mbledhje. Mospjesëmarrja në mbledhje nuk ndikon në llogaritjen e kuorumit.

(Amenduar me vendimin nr. 4, datë 26 shkurt 2019 të Asamblesë së Akademisë së Shkencave)

Mospjesëmarrja në mbledhjet e Asamblesë e anëtarëve të rregullt, të përhershëm dhe të asociuar sjell përgjegjësi sipas këtij Statuti. Në rastin kur anëtari nuk merr pjesë në asnjë mbledhje pa arsye për një vit rresht, Kryesia e Akademisë, me vendim, ndërpret për një vit shpërblimin financiar për titullin “akademik”.

(Amenduar me Vendimin nr. 15, datë 30 qershor 2017 të Asamblesë së Akademisë së Shkencave)

Neni 15

Asambleja shqyrton dhe miraton drejtimet kryesore të veprimtarisë shkencore të Akademisë, vendos për çështje të tjera të rëndësishme me karakter shkencor e organizativ; miraton Statutin dhe ndryshimet që mund të bëhen në përmbajtjen e tij; zgjedh anëtarët e rinj të rregullt, të përhershëm, të asociuar e të nderit; zgjedh kryesinë dhe kryetarët e seksioneve; shqyrton dhe miraton raportet e Kryesisë për veprimtarinë e përgjithshme të Akademisë; shqyrton probleme të zhvillimit perspektiv të shkencave në vend dhe u paraqet propozime organeve kompetente.

Neni 16

Rendi i ditës i mbledhjes së Asamblesë caktohet nga Kryesia dhe miratohet nga Asambleja.

Asambleja merr vendim kur në mbledhje merr pjesë shumica e anëtarëve të saj. Në rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjen e organeve dhe të autoriteteve drejtuese, si dhe me zgjedhjen e anëtarëve të saj, mbledhjet e Asamblesë janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se $\frac{3}{4}$ e anëtarëve të saj.

Të gjitha çështjet zgjidhen nga Asambleja me votim të hapur dhe me shumicën e anëtarëve të pranishëm, përveç rasteve kur në Statut parashikohet ndryshe. Miratimi i Statutit dhe ndryshimi i tij bëhen kur votojnë në favor jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të Asamblesë.

Neni 17

Asambleja zgjedh me votim të fshehtë për një mandat katërvjeçar kryetarin e Akademisë e zëvendëskryetarin dhe për një mandat pesëvjeçar sekretarin shkencor dhe kryetarët e seksioneve.

Në çdo rast, mandati i anëtarit të Kryesisë dhe Këshillit Ekzekutiv vazhdon deri në zgjedhjen e të riut, për një periudhë jo më të gjatë se 3 muaj.

(Amenduar me vendimin nr. 4, datë 26 shkurt 2019 të Asamblesë së Akademisë së Shkencave)

Kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari shkencor përbëjnë Kryesinë e Akademisë. Në Kryesinë e Akademisë duhet të përfaqësohen të dyja seksionet e saj.

Këshilli Ekzekutiv përbëhet nga 5 anëtarë: kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor i Akademisë dhe kryetarët e seksioneve.

Kryetari i Akademisë është edhe kryetar i Këshillit Ekzekutiv.

Neni 18

Kryetari i Akademisë duhet të jetë anëtar i rregullt ose i përhershëm i Akademisë.

Kandidati për t'u zgjedhur Kryetar i Akademisë së Shkencave duhet të plotësojë paraprakisht pyetësorët: 1. *Formular aplikimi për informim për zyrtarët përpara emërimit / zgjedhjes në poste të larta*, parashikuar në nenin 29, pika 1, germa gj, të Ligjit nr. 45/2015 *Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*"); 2. *Formular vetëdeklarimi* për mosekzistencën e shkaqeve që pengojnë kandidimin /

emërimin, parashikuar në Ligjin nr. 138/2015 *Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.*

(Amenduar me Vendimin Nr. 15, datë 30 qershor 2017 të Asamblesë së ASH-së)

Zgjedhja e tij bëhet nga Asambleja drejtpërdrejt dhe me votim të fshehtë. Quhet i zgjedhur akademiku që fiton shumicën e cilësuar absolute (50%+1) të votave të të gjithë anëtarëve të Asamblesë. Në rast se asnjë kandidat nuk fiton shumicën e cilësuar absolute të votave të anëtarëve të Asamblesë, votimi përsëritet, duke qenë kandidatë dy akademikët që kanë marrë më shumë vota. Në rast se edhe në votimin e dytë asnjë nga kandidatët nuk arrin të fitojë shumicën absolute të votave zbatohet parimi i shumicës së thjeshtë (jo më pak se 50%+1) të anëtarëve të pranishëm të Asamblesë.

Kryetari i zgjedhur i Akademisë emërohet me dekret të Presidentit të Republikës.

Neni 19

Zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve zgjidhen drejtpërdrejt me votim të fshehtë nga Asambleja, nga radhët e anëtarëve të rregullt, të përhershëm dhe të asociuar.

Kandidati për t'u zgjedhur Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave dhe / ose Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave duhet të plotësojë paraprakisht pyetësorët: 1. *Formular aplikimi për informim për zyrtarët përpara emërimit / zgjedhjes në poste të larta*, parashikuar në nenin 29, pika 1, germa gj, të Ligjit nr. 45/2015 *Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*"); 2. *Formular vetëdeklarimi për mosekzistencën e shkaqeve që pengojnë kandidimin / emërimin*, parashikuar në Ligjin nr. 138/2015 *Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.*

(Amenduar me Vendimin Nr. 15, datë 30 qershor 2017 të Asamblesë së ASH-së)

Modalitetet e votimit dhe të vlefshmërisë së rezultatit janë të njëjta si në rastin e kryetarit të Akademisë.

Kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe kryetarët e seksioneve mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion për dy mandate, por jo radhazi.

Neni 20

Në rast se vendi i kryetarit të Akademisë mbetet i lirë përpara mbarimit të mandatit, zgjidhet kryetari i ri sipas procedurës së parashikuar në nenet 17 e 18.

Po kështu veprohet për anëtarët e tjerë të Kryesisë, sipas procedurës së parashikuar në nenin 19.

Neni 21

Këshilli Ekzekutiv zbaton vendimet e Asamblesë; shqyrton probleme të rëndësishme shkencore e organizative, duke marrë vendimet përkatëse. Për gjithë veprimtarinë e tij Këshilli Ekzekutiv raporton para Asamblesë.

Vendimet e Këshillit Ekzekutiv merren me votim të hapur dhe me shumicën e anëtarëve të pranishëm, kur këta përbëjnë shumicën.

Neni 22

Kryesia e Akademisë organizon, drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e Akademisë; vendos marrëdhënie e lidh marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendëse e të huaja; vendos për mbledhjen e Asamblesë; miraton ndarjen e kuotave të buxhetit sipas fushave të veprimtarisë së Akademisë.

Kryetari i Akademisë përfaqëson Akademinë në marrëdhëniet e saj me institucionet e vendit dhe të shteteve të tjera, siguron lidhjet me organet shtetërore, thërret dhe drejton mbledhjen e Asamblesë, të Këshillit Ekzekutiv dhe të Këshillit të Botimeve.

Në gjithë veprimtarinë dhe ushtrimin e funksioneve të tij kryetari ndihmohet nga zëvendëskryetari dhe sekretari shkencor. Në rast mungese të kryetarit, zëvendëskryetari e zëvendëson në të gjitha funksionet e tij.

Zëvendëskryetari ndjek e bashkërendon punën e seksioneve, miraton programet e veprimtarisë së tyre kryesore-organizative dhe ndihmon për mbarëvajtjen e tyre.

Sekretari shkencor ndjek zbatimin e vendimeve të Asamblesë, të Këshillit Ekzekutiv dhe të Kryesisë, përgatit mbledhjet e tyre, kujdeset për paraqitjen e programit shkencor të Akademisë dhe të raporteve për veprimtarinë e

përgjithshme të saj, sipas programeve dhe raporteve të paraqitura nga seksionet e organizmat e tjerë, mbikëqyr veprimtarinë e aparatit administrativ të Akademisë.

Neni 23

Kryesia e Akademisë ka aparatit e vet, që funksionon sipas rregullores së miratuar prej saj.

V

Seksionet e Akademisë së Shkencave

Neni 24

1. Seksionet e Akademisë janë njësi shkencore, të cilat, në përshtatje me vendimet e Asamblesë, të Këshillit Ekzekutiv dhe të Kryesisë së Akademisë, realizojnë detyrat e përcaktuara në Ligjin dhe në Statutin e Akademisë.

2. Seksionet ndahen në:

- a) Seksioni i shkencave shoqërore albanologjike;
- b) Seksioni i shkencave natyrore e teknike.

Neni 25

Seksionet e Akademisë:

a) Orientojnë, organizojnë, bashkërendojnë dhe ndjekin veprimtarinë shkencore në fushat e shkencave që mbulojnë;

b) ndjekin gjendjen dhe zhvillimin e shkencave që mbulojnë, studiojnë dhe paraqitin perspektivat e zhvillimit të këtyre shkencave, bëjnë propozime për ngritje institutesh e qendrash shkencore, për ngritje grupesh të veçanta për studime ndërdisiplinore, për ngritje komisionesh studimi për probleme të caktuara të rëndësishme, duke aktivizuar edhe specialistë të jashtëm;

c) bëjnë propozime dhe marrin masa për organizim kongresesh, konferencash, simpoziumesh e seminaresh shkencore me karakter kombëtar e ndërkombëtar për probleme ndërdisiplinore;

ç) caktojnë kriteret themelore për botimet akademike të profilit të tyre; botojnë revista shkencore të specializuara, redaksitë e të cilave funksionojnë pranë këtyre seksioneve dhe kryesohen nga kryetarët e seksioneve;

d) përcaktojnë ndarjen e kuotave të këtyre botimeve;

dh) diskutojnë e japin mendim për botimin e veprave akademike të fushave përkatëse;

e) shqyrtojnë e japin mendim paraprak për kandidatët që aplikojnë për akademikë të rregullt e të asociuar.

Neni 26

Seksioni përbëhet prej anëtarëve të rregullt, anëtarëve të përhershëm dhe anëtarëve të asociuar të Akademisë sipas profilit përkatës. Sekretari shkencor i seksionit është punonjës i aparatit të Akademisë me titull shkencor “Profesor”. Në mbledhjen e Seksionit mund të ftohen edhe punonjës mësimorë-shkencorë të jashtëm, sipas çështjeve që shqyrtohen.

Vendimet në mbledhjet e Seksionit merren me votim të hapur dhe me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Seksionit, me përjashtim të rasteve kur në ligj ose në akt nënligjor parashikohet ndryshe.

Seksioni, si rregull, mbledhet tre-katër herë në vit, sipas problemeve që do të shqyrtojë.

Neni 27

Seksioni drejtohet nga kryetari i tij.

Kryetari i Seksionit thërret dhe drejton mbledhjet e Seksionit.

Neni 28

Pranë Akademisë funksionojnë Këshilli i Botimeve dhe njësi mbështetëse administrative. Kryetari i Akademisë është edhe kryetar i Këshillit të Botimeve.

Neni 29

Pranë Akademisë funksionojnë Biblioteka shkencore e specializuar dhe Qendra e dokumentacionit.

VI

Mbështetja e veprimtarisë shkencore dhe financimi

Neni 30

1. Akademia është institucion buxhetor dhe të ardhurat i siguron nga:

- a) Buxheti i shtetit;
 - b) shërbimet tekniko-shkencore, që kryhen për persona juridikë e fizikë jashtë sistemit të saj;
 - c) aplikimet, projektet, dhuratat, subvencionet e sponsorizimet.
2. Të ardhurat e krijuara sipas shkronjave “b” e “c” të pikës 1 të këtij neni përdoren në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
 3. Çdo akademik mund të aplikojë për mbështetjen e projekteve kërkimore-shkencore. Projekti dorëzohet në seksionin përkatës, i cili ia dërgon atë Kryesisë së Akademisë së bashku me një vlerësim mbi projektin. Seksioni nuk ka të drejtë të vendosë për financimin ose jo të tij. Vlerësimi i projektit bëhet nga një anëtar i seksionit dhe një studiues jashtë Akademisë.
 4. Asambleja e Akademisë shqyrton vlerësimet e ardhura nga seksionet për projektet e paraqitura dhe vendos për mbështetjen ose jo të tyre me votim të hapur.
 5. Në fund të çdo viti, Akademia harton edhe raportin e detajuar financiar i cili bëhet pjesë e raportit vjetor të veprimtarisë së Akademisë.

Asambleja e Akademisë së Shkencave